



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Ministri Bushati mori pjesë në konferencën 'Pritshmëri të larta për vitin 2018. Hapi pasardhës i Shqipërisë në procesin e integritimit evropian'

2017-12-05 10:19:00



Gjatë vizitës së tij në Bruksel më 4 dhjetor 2017, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, mori pjesë në konferencën 'Pritshmëri të larta për vitin 2018. Hapi pasardhës i Shqipërisë në procesin e integritimit evropian'. Konferenca u organizua nga Fondacioni gjerman "Hanns Seidel".

Në konferencë morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm për Zgjerim në Komisionin Evropian, Christian Danielsson, eurodeputeti Eduard Kukan, përfaqësues të institucioneve të BE dhe të vendeve anëtare, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

Ministri Bushati bëri një paraqitje të detajuar të hapave që ka ndërmarrë qeveria në kuadër të angazhimeve për plotësimin e përparësive kyçe, duke e vënë theksin tek ecuria e zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë si dhe në luftën pa kompromis kundër kimit të organizuar. Bushati theksoi se, pritshmëritë e qeverisë dhe shoqërisë shqiptare që bazohen në punën e bërë dhe progresin e arritur, e bëjnë vitin 2018 të veçantë dhe përcaktues për hapat e mëtejshëm në konkretizimin e procesit evropian të Shqipërisë. Duke argumentuar mbi rëndësinë që ka marrja e vendimit për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit për Shqipërinë, Bushati nënvizoi gatishmërinë e qeverisë për t'u angazhuar në këtë ushtrim transformues për vendin dhe shoqërinë. "Arritjet tona përbëjnë tashmë një bazë solide për përparim thelbësor e cilësor në procesin e integritimit të një sërë fushash parësore, në mënyrë të veçantë për kapitujt 23 dhe 24", theksoi Bushati. Ai nënvizoi se Shqipëria ndjehet e inkurajuar nga përforcimi i mbështetjes për zgjerimin në Ballkanin Perëndimor të shprehur së fundmi si nga Presidenti i Komisionit Evropian Juncker, por edhe nga Presidenti francez Macron. "Ne shpresojmë që kjo mbështetje të konkretizohet në hedhjen e hapave të mëtejshme në udhëtimin tonë evropian, në përputhje me arritjet dhe meritat tona, për ta çuar marrëdhënien tonë të pakthyeshme me institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet e tij anëtare në nivelin që imponon dinamika e shumëfishuar e bashkëpunimit dhe ndërveprimit mes nesh".

Drejtori i Përgjithshëm për Zgjerim në Komisionin Evropian, Christian Danielson, përgëzoi qeverinë shqiptare për ecurinë e reformave, në mënyrë të veçantë asaj në drejtësi dhe theksoi rëndësinë e ruajtjes së ritmit të tanishëm. "Dinamika e zhvillimeve në Shqipëri", theksoi ai, "po krijon një besim në rritje në Bashkimin Evropian se ka ardhur koha për të ecur më tej në procesin e integritimit evropian". Ai theksoi se në shkurt 2018 Komisioni do të paraqesë strategjinë e zgjerimit dhe në muajin prill do të prezantojë raportin mbi Shqipërinë ku do të paraqiten propozimet e Komisionit mbështetur në analizën e rezultateve të arritura në plotësimin e pesë përparësive kyçe.

Raportuesi për Shqipërinë, eurodeputeti Eduard Kukan, theksoi se ai ishte dëshmitar i ndryshimeve të ndodhur në Shqipëri, të cilat, sipas tij kanë krijuar besim tek të dy grupimet e mëdha politike në Parlamentin Evropian për ta ftuar sa më parë Shqipërinë në

tavolinën e bisedimeve për anëtarësi.
Ministri Bushati dhe panelistët e tjerë iu përgjigjën edhe pyetjeve të
ndryshme të audiencës.